



Pranimar / Dorezuar / Prilbena / Prodato Received / Delivered	04.06.2021	viti god year	1
Organ / Pjesa Organ / Jednica Org / Unit	Nr. Prot Nr. Prot Prot No	Shtojca Protog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKINSHOK	2891/2021		113



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.368/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Zyle Millaku Gojnovci-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, duke u bazuar në Aktgjykimin A.nr.2730/2019 të datës 29.04.2021 të Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative, kanë shqyrtuar ankesën numër A.nr.408/2019 të datës 17.07.2019 të parashtruar nga ankuesi përmes përfaqësuesit të autorizuar Avokati Selman Rexhepi, nga Gjilani, kundër Vendimit me numër nr.346/2019 të datës 17.06.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 03.06.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.408/2019 e datës 17.07.2019, e parashtruar nga ankuesi

II. SHFUQIZOHET Vendimi me numër 346/2019 i datës 17.06.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Agjencisë për Barazi Gjinore në Zyrën e Kryeministrit.

A r s y e t i m

Ankuesi, i punësuar në Zyrën e Kryeministrit sipas Akt emërimi me numër 215/2011 të datës 24.10.2011 në pozitën „Zyrtar i lartë për legjislacion” në Agjencinë për Barazi Gjinore, me Vendimin e datës 14.02.2019 me numër protokoll 050/2019 të Kryeshefes Ekzekutive të Agjencisë për Barazi Gjinore, është caktuar për kryerjen e detyrës shtese si Zyrtar Certifikues-alternativ me koeficient të njëjtë të pagës.

Ankuesi Vendimin e datës 14.02.2019 me numër protokoll 050/2019 të Kryeshefes Ekzekutive të Agjencisë për Barazi Gjinore, e ka pranuar me date 20.02.2019, ndërsa me datë 11.06.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Agjencinë për Barazi Gjinore.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Agjencisë për Barazi Gjinore me datë 17.06.2019 ka nxjerre vendimin me numër 346/2019 me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër numër 346/2019 të datës 17.06.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Agjencisë për Barazi Gjinore, me datë 17.07.2019 ka parashtruar ankesë Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me numër 3178/2019.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 13.08.2019, ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Agjencia për Barazi Gjinore. Me datë 18.08.2019 te Agjencisë për Barazi Gjinore, duke bashkangjitur dokumentacionin.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar të vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 17.06.2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka njoftuar ankuesen për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi ka ndjekur procedurat e tjera duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë–Departamenti për Çështje Administrative më datë 29.04.2021 ka nxjerr Aktgjykim A.nr.2730/2019 me të cilin ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit duke anuluar njoftimin e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës të datës 17.06.2019 dhe duke e detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda 30 ditësh të vendos për ankesën e datës 17.07.2019.

**Kolegji për shqyrtimin e ankesave për marrjen e vendimit meritor ka administruar këto prova:** Aktgjykimit A.nr.2730/2019 të datës 29.04.2021 të Gjykatës Themelore-Departamenti për Çështje Administrative; Ankesën me numër protokollit 3178/2019 të datës 17.07.2019 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin me numër nr.346/2019 të datës 17.06.2019 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Ankesa e datë 11.06.2019 për Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Akte emërimi i datës 24.10.2011; përgjigje e datës 15.08.2019; Vendim i datës 07.07.2018; Shkresë- kartela e nëpunësit e datës 14.08.2019; E-mail zyrtar i datës 14.08.2019, 14.07.2019, Njoftimi datës 02.05.2019; Përgjigje ne ankesë e datës 14.08.2019; procesverbali i datës 17.06.2019; Prova shtese e datës 19.07.2019; Autorizimi i datës 07.07.2019; Vendim i datës 22.05.2017.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit **është e pabazuar:**

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, duke u bazuar në dëshmitë e ofruara nga ankuesi dhe Organi i punësimi, ka konstatuar që ankuesi Vendimin me numër protokollit 050/2019 të datës 14.02.2019 të Kryeshefes Ekzekutive të Agjencisë për Barazi Gjinore, me të cilin është caktuar për kryerjen e detyrës shtese si Zyrtar Certifikues-alternativ me koeficient të njëjtë të pagës, e ka pranuar me date 20.02.2019, ndërsa me datë 11.06.2019 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave në Agjencinë për Barazi Gjinore, jashtë afatit të përcaktuar ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh për parashtrimin e ankesave, respektivisht ankesa është parashtruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 8 paragrafit 2 të Rregullores Nr.05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, ku është përcaktuar se: **“Ankesa duhet të paraqitet brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga momenti kur nëpunësi civil konsideron se i janë shkelur të drejtat e tij nga marrëdhënia e punës”**, si dhe në kundërshtim me dispozitat e nenit 127, paragrafin 1 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: **“Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ”** sepse ne rastin konkret momenti kur ankuesit i ka filluar të rrjedhë afati ligjor për ankimim është atëherë kur ankuesi e ka pranuar Vendimin me numër 050/2019 të datës 14.02.2019 gjegjësisht nga data 20.02.2019. Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se ne rastin konkret ankuesi ankesën në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave te Agjencisë për Barazi Gjinore, e ka parashtruar pas kalimit të afatit tridhjetë ditor (30), përkatësisht në ditën e njëqind e dymbëdhjetë (112) pas pranimit të vendimit nga ana e ankuesit, me çka nënkuptohet se është jashtë afatit ligjor për parashtrimin e ankesave.



Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Agjencisë për Barazi Gjinore, me rastin e nxjerrjes së Vendimit numër .346/2019 të datës 17.06.2019, me te cilin e ka refuzuar ankesën e ankuesit, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, sepse nuk ka arritur që të trajtoj drejtë gjendjen faktike dhe juridike, lidhur me procedurën e ndjekur të ankimit respektivisht afatshmërinë e ankesës të parashtruar nga ana e ankuesit në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave.

Bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

### KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.368/2021

Zyle Millaku Gojnovci

Procesmbajtëse

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

#### Vendimi i dërgohet

- Avokati (për ankuesin );
- Kryeshefit Ekzekutiv të Agjencisë për Barazi Gjinore;
- Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë për Barazi Gjinore dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së .